

01-528
21.08.2020



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo



KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

Anëtarit të Komitetit për Politikë dhe Financa
Z/znj _____

Në bazë të dispozitave të nenit 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale si dhe në bazë të dispozitave të nenit 41 të Statutit të Komunës së Novobërdës.

F T O J

Mbledhjen e katërt të Komitetit për Politikë dhe Financa e cila do të mbahet më 27.08.2020 (e enjte) duke filluar në ora 10:00.

R e n d i i d i t ë s

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-se;
2. Shqyrtimi i Raporti të Auditimit për pasqyrat Financiare të Komunës së Novobërdës për vitin 2019;
3. Bartja e mjeteve të pashpenzuara nga viti 2019 në vitin 2020;
4. Raporti i korrje - shirjeve për vitin 2020;
5. Të ndryshme.

Mbledhja do të mbahet në hapësirat e K.K-së në Novobërdë.

Më:21.08.2020
Në: Novobërdë



Kryesues i Kuvendit
Nebojsa Arsic

(Handwritten signature)



01-529
21.08.2020

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosova

Komuna e Novobërdës

Opština Novo Brdo–Municipality of Novo Brdo



KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e tretë e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më 22.06.2020, duke filluar në orën 10:00. Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesusi i Kuvendit Nebojsa Arsic, Anëtarët e KPF-së: Mirjana Simijonovic, Milica Jovanovic, Xhejlane Behluli, Selatin Nuhiu, Drejtori i Financave Sercan Todorovic.

Kryesuesi pasi përshëndeti të pranishmit tha: Para se të fillojmë me rendin e ditës duhet konstatuar kuorumin prezentë janë të gjithë antarët e KPF-së pas kësaj e hapi mbledhjen me këtë:

R e n d d i t e

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-se;
2. Bartja e mjeteve të pashpenzuara nga viti 2019 në vitin 2020;
3. Shqyrtimi i Kornizes Afatmesme Buxhetore (KAB) 2021-2023;
4. Të ndryshme.

Kryesusi tha i pyeti të pranishmit se a pajtohen me këtë rend dite apo keni ndonjë propozim?

Selatin Nuhiu pasi përshëndeti të pranishmit tha: e kam një propozim për Kuvend, kërkoj një raport nga Shtabi Emergjent për menaxhimin e situatës së pandemis Covid 19 deri me tani.

Kryesusi i pyeti se kush është që të shtohet edhe kjo pikë në rend dite?

Aprovohet njëzëri kjo pikë që të futet në rend dite.

Pika e parë: Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-se;

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi nuk pati vërejtje procesverbali aprovohet njëzëri nga antarët e KPF-së.

Pika e dytë: Bartja e mjeteve të pashpenzuara nga viti 2019 në vitin 2020;

Kryesuesi për këtë pikë ja dha fjalën Drejtorit të Financave Sercan Todorovic.

Sercan Todorovic pasi përshëndeti të pranishmit tha: siç e din na duhet vendim i Kuvendit për bartje të mjeteve, bëhet fjalë për një shumë mbi 54000€, në Drejtorinë e Shendetësisë, mallra dhe shërbime janë 8479.54€, në Administratë dhe Personel, shërbime komunale janë 97,52€, në zyrë të Kryetarit, subvencione janë 7€ dhe në Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik, shpenzime kapitale janë 46,250€.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Selatin Nuhiu tha: qysh me i barët këto mjete kur nuk kemi raport financiar vjetor për vitin 2019. Drejtori nuk ka sjell raport vjetor që ne me i pa pasqyrat se si janë shpenzuar ato mjete, propozoj që kjo pikë të mos shkoj më tutje por të ndërprehet këtu deri sa të vij raporti financiar vjetor.

Sercan Todorovic tha: faji është se nuk kemi pasur mbledhje dhe ajo është arsyeja se pse se kemi derguar, pasi që raporti është i pregaditur, gjithashtu edhe raportin tremujor e kemi të pregaditur, por për arsye të urgjencës pasi që është edhe periudha afatmesme buxhetore që duhet të shkoj në qeveri dhe të aprovohet e kemi dhënë këtë propozim, janë mjete për ndriqim dhe kanalizim që vitin e kaluar i kemi aprovuar vetëm duhet të barten për projekte që nuk janë realizu në vitin e kaluar e duhet të realizohen këtë vit. Duke mos dashur ta ngarkoj

me 4 pika KPF-ën dhe Kuvendin me raport vjetor, tremujor dhe më keto dy pika tjera, kam sjell vetem këto dy pika dhe për mbledhjen e ardhshme do ta keni edhe raportin financiar.

Selatin Nuhiu tha: unë jam i bindur që me 31 janar Drejtori e ka dorzuar raportin në Ministri të Financave, andaj është duhur që në mbledhje të janarit të na vij raporti vjetor.

Sercan Todorovic tha: me 31 janar është pregadit raporti, Kuvendi është mbajta para datës 31 janar, pasatj është afati 30 ditor që na kthen Ministria e Financave pergjigjen.

Selatin Nuhiu tha: ka pasur mundësi që të vij në fund të muajit shkurt.

Sercan Todorovic tha: afati ligjor prej momentiti të dorzimit deri në momentin e kthimit nga Ministria është 30 ditë për këtë arsye skemi pasur mundësi ta dergojm për Kuvend në muajin shkurt.

Selatin Nuhiu tha: unë propozoj që kjo pikë të hudhet në votim nese kalon në rregull, por Drejtori duhet me qenë me i sinqert me Kuvendin me na sjell raporte të sakta financiare.

Sercan Todorovic tha: mjetet që i kemi propozuar për bartje janë mjete nga të hyrat vetanake dhe është një pjesë e investimeve kapitale, këto hapsira i kemi pas të lira dhe nuk mundë ti redistinojm por patjeter duhet të barten në të njejtin vend ku kan qenë.

Xhejlane Behluli pasi pershendeti të pranishmit tha: atëher nese kem kohë për me shty këtë raport e shtym për muajin tjetër nese nuk kem problem me Ministri, le të vij raporti vjetor financiar dhe tremujori i parë i këtij viti.

Sercan Todorovic tha: kjo ska lidhje me raportin financiar, këto mjete vetem duhet të barten, janë mjete që kanë mbet te viti 2019.

Xhejlane Behluli tha: atëher unë jam për me perkrah, pasi që janë në pyetje vetem projektet që kanë mbet pa u realizu vitin e kaluar, projektet që i keni votuar ju vetem ato mjete po barten që të realizohen projektet në këtë vit.

Selatin Nuhiu tha: këto mjete mundë të barten edhe pas një viti, pasi që nuk e kan afatin e caktuar, këto mjete janë prej të hyrave vetanake.

Sercan Todorovic tha: problemi është që në bazë të projekteve të cilat i keni aprovuar, i kemi bërë kontratat, nese si bartim mjetet smund ti paguajm projektet që janë në realizim e siper.

Selatin Nuhiu tha: unë mendoj se nese ishin menaxhu mirë financat në Komunën e Novobërdës, kjo pikë e rendit të ditës nuk kish pas nevoj me ardh këtu hiq.

Sercan Todorovic tha: këto mjete janë të mbledhura në fund të dhjetorit dhe atëher kemi konstatuar se sa mjete kemi nga të hyrat vetanake dhe skemi pas afat që ti hargjojm.

Xhejlane Behluli tha: Selatin perderisa vet ju i keni propozu dhe aprovua projektet dhe po i publikoni ato që po kryhen, po flas për investimet kapitale që janë shumë të rëndësishme që të barten, e kemi votu bashk me buxhet, ato projekte që të realizohen duhet të barten këto mjete.

Selatin Nuhiu tha: askush nuk mundë të më bind se financat udhëheqen mirë në Komunën tonë, le tmë tregon Drejtori se sa mjete janë marr nga permbaruesi privat vitin e kaluar.

Sercan Todorovic tha: në çdo Komunë ndodh bartja e mjeteve, sa i perket permbaruesit privat i keni raportet tremojre që i keni marrë.

Milica Jovanovic pasi pershendeti të pranishmit tha: ku e keni listen e projekteve deri kur është afati që të realizohen dhe a janë ato proejkte që janë realizuar?.

Sercan Todorovic tha: jane projektet që vitin e kaluar janë aprovuar për kanalizim, ndriqimi është perfunduar vetem duhet të paguhet.

Pasi nuk pati tjera diskutime me 1 vot për, 4 vota kunder (Nebojsa Arsic, Selatin Nuhiu, Milica Jovanovic, Mirjana Simijonovic, nuk aprovohet kjo pikë që të shkoj në Kuvend.

Pika e tretë: Shqyrtimi i Kornizes Afatmesme Buxhetore (KAB) 2021-2023;

Kryesuesi për këtë pikë ja dha fjalen Drejtorit të Financave Sercan Todorovic.

Sercan Todorovic tha: ju kerkoj falje që se keni marr materialin edhe në gjuhen serbe, i kemi pas disa probleme teknike dhe skemi pasur mundësi ta pregadisim materialin, nese keni ndonjë pyetje urdhëroni, nese nuk keni propozoj që kjo pikë të shkoj në Kuvend e pastaj aty do të keni edhe kohë që ta analizoni më shumë këtë pikë.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Milica Jovanovic tha: materialin e kemi marrë 5 minuta para mbledhjes dhe nuk kemi pasur kohë që ta lexojmë.

Mirjana Simijonovic pasi pershendeti të pranishmit tha: po thuani se po pregaditni prej shtepisë që të votojmë kunder, mirëpo që 3 vite po na ndodhë që po funksionon Kuvendi, ne po kerkojmë në Kuvend raporte dhe ato raporte nuk po na vin me kohë dhe është bërë praktik që të na vij materiali sot pasi që nuk kemi kohë, ne nuk po vim të pregaditur që të votojmë diçka kunder. Sa kohë punon Komuna prej momentit të karantimit po e pyes Drejtorin?

Sercan Todorovic tha: që 3 javë.

Mirjana Simijonovic tha: për 3 javë nuk keni mundur ta pregaditni materialin me kohë, neve na kanë sjellë qytetarët që ti mbrojmë interesat e tyre. Nese vini në Kuvend që të kryejtë ndonjë punë ne do të votojmë.

Sercan Todorovic tha: a duhet të punoj kështu ti sjell 4 pika nga Drejtoria e Financave dhe tju ngarkoj juve me pika.

Mirjana Simijonovic tha: ju sjeni duke e kryer punën tuaj si ekzekutiv dhe në si Kuvend e kryejmë punën tonë.

Selatin Nuhiu tha: për ne le ti bjen Drejtori 20 pika ne atë punë e kemi, i vetmi ti Drejtor je që vjen në Kuvend dhe raporton dhe ti vjen për pikat që i ki patjetër.

Xhejlane Behluli tha: po foli në bazë të përvojës që e kemi me këtë korniz që na vjen për çdo vit, kjo është vetëm një shqyrtim, vetëm me diskutu e dergojmë në Kuvend e pastaj atje ose aprovone ose anulone, duhet ta dini se edhe sherbimi ndaj qytetarëve varet prej vendimeve që i marrim ne në Kuvend e ju vendoseni.

Pasi nuk pati tjera diskutime me 4 vot për, a apstenim aprovohet kjo pikë që të shkoj në Kuvend.

Pika e katërt: Raport nga Komisioni Komunal i Emergjencës rreth menaxhimit të situatës së pandemis;

Kryesusi tha: pasi që kjo pikë është propozu sot nuk kemi se çka të diskutojmë, vetëm e aprovojmë që të shkoj në Kuvend.

Pasi nuk pati diskutime aprovohet njëzëri nga të gjithë antarët prezent që të shkoj në Kuvend.

Pika e pestë: Të ndryshme.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Milica Jovanovic tha: dua ti permendi problemet të cilat i kanë qytetarët në Komunën e Novobërdës e nuk janë probleme që zgjasin me muaj por me vite, problemi kryesor është transporti i qytetarëve Novobërdë-Llabjan, duke pas parasysh se jemi zon rurale dhe kemi qytetar të vjetër dhe jemi shumë të varfër mendoj se ky transport është shumë i nevojshëm për qytetarët, pastaj e kemi pastrimin e vazrrezave, ku muajin e kaluar e kemi pasur një manifestim fetar të varrezat, kam parë në disa faqe se në Bostan ka ndihmu Komuna në pastrim të varrezave ndersa në vendbanimet tjera jo, e kemi edhe mbykqyrjen me kamera në Prekovic ku që një vit nuk funksionon si dhe rruga në Stanishor dhe tregu në Llabjan mendoj se gjendet në rrugë kryesore dhe të gjithë janë të rrezikuar, jemi të zgjedhur nga qytetarët dhe duhet të ndëgjohet zëri ynë.

Xhejlane Behluli tha: po lidhem me kërkesën e Milices, sa i përket pastrimit të varrezave po flas për fshatin tonë, nuk është se i ndihmon Komuna por me iniciativ të kshillit të fshatit vet i pastrojnë, të vetmen ndihmë që e kemi pasur në Pasjak nga Komuna është rrethoja e varrezave.

Mirjana Simijonovic tha: në mes të Koretishtës dhe Strazhes i kemi 6-7 gurthyes, i dimi problemet në Stanishor dhe me të vertet është një katastrofë e madhe, rruga e Stanishorit është rrugë regjionale por tash e kemi në rritje edhe numrin e këtyre kamionëve që po kalojnë edhe në Koretishtë andaj i lus organet që të mirren me këtë qëshetje të vendosin një shenjë me kufizim të peshës 3.5 ton pasi që në Koretishtë rrugët janë lokale dhe rrezikon jetën e pleqëve dhe të fëmijëve.

Xhejlane Behluli tha: sa i përket gurthyesve kemi ankesa edhe prej banorëve të fshatit Stanishor por mendoj se ky problem duhet me u drejtuar në Ministri nuk varet vetëm prej Komunës tonë.

Mirjana Simijonovic tha: më intereson të di se a duhet ai gurthyes të kërkojë ndonjë leje ose pelqim apo ndonjë dokument prej Komunës, nuk mund të ndertohen gurthyesi në vendbanim pa u marrë ndonjë dokument në Komunë.


Kryesuesi tha: para disa muajve e kemi pasur një takim në Stanishor me përfaqësuesit e OSBE-së, KFOR-it dhe këta përfaqësues kanë thënë se kanë qenë në Ministri por Komuna i ka dhënë pelqimet që gurthyesi të vazhdojë punën.

Pasi nuk pati diskutime Kryesuesi i falëndëroi të pranishmit për pjesëmarrje.
Mbledhja përfundoi në orën 11:0.

Procesëmbajtëse
Valmire Mustafa



Kryesues i Kuvendit
Nebojsa Arsic



05-330
16.06.2020



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

DIREKTORAT BUDZET I FINANSIJE
DREJTORIA BUXHET DHE FINANCA

DATË/A:	06.04.2020
PËR/ZA/TO:	Skupština Opštine Novo Brdo/Kuvendi Komunes Novobërdë
C.C.C:	
NGA/OD/FROM:	g. Srdjan Todorović – direktor/drejtor
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Izveštaj prenosa neutrošenih sredstava/Raport bartja e mjeteve te pashpenzuara

Prenos neutroshenih sredstava od 2019 u 2020 godine.
Bartja e mjeteve të pashpenzuara nga viti 2019 në vitin 2020.

Opština Novo Brdo / Komuna Novobërdë

Program/ Programi	Kod podprograma / Kodi nenprogramit	Funksionalni kod / kodi funksional	Izvorni fond / Fondi burimor	Ekonomska kategorija / Kategoria ekonomike	Ekonomska podkategorija / Nën kategorit ekonomike	Opis / Pershkrimi	Prenos 2019 / Bartja 2019
Direktorat Zdravstva / Drejtoria Shëndetsis	74800	0721	22	13	130	Robe i usluge / Mallra dhe Sherbime	8.479,54 €
Robe i usluge / Mallra dhe Sherbime							8.479,54 €
Administracija i osoblje / Administrat dhe Personel	16330	0133	22	14	132	Opštinski troškovi / Shërbime komunale	97,52 €
Opštinski troškovi / Shërbime komunale							97,52 €
Kancelarija Gradonačelnika / Zyra e Kryetarit	16030	0111	22	13	200	Subvencije / Subvenceione	7,06 €
Subvencije i transferi / Subvenceione dhe transfere							7,06 €
Direktorat Ekonomskog razvoja / Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik	48030	0411	22	30	300	Osvetljenje/Ndrrqimi pub. Trotoar/Trotuar Kanalizacija/Kanalizimit	➤ 10.000,00 ➤ 4.421,00 31.829,00
Kapitalni troškovi / Shpenzime Kapitale							46.250,00 €
Ukupno za prenos / Totali per bartje							54.834,12 €